



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljepra / Pristato Received / Delivery	05.05.2023	3	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shillojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKANSHEK	4119/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.482/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.482/2023 të datës 10.03.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Eduard Liri", nr.95, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 05.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.482/2023 e datës 10.03.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Vërejtja me Nr.Prot.7562/22 të datës 12.12.2022 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore si Udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankueses.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunëses civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas Ndryshim Plotësimit të Akt emërimit të datës 11.07.2017 në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore”, në kuadër të Departamentit-Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore. Me datën 12.12.2022, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, përmes shkresës zyrtare me Nr.Prot.7562/22 i ka shqiptuar ankueses masën Vërejtje me shkrim, me arsyetimin për sjellje jo të mira.

Ankuesja e pakënaqur me Vërejtjen e shqiptuar të datës 12.12.2023, e shqiptuar nga ana e Udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë, me datën 10.03.2023, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:2559/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vërejtjes me shkrim në fjalë për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës të përgjithshme administrative dhe legjislacionit për Zyrtarët Publikë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 28.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit me datën 12.04.2023 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 19.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses Makfirete Dibrani edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 2559/2023 të datës e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Prot.8346 të datës 09.12.2022; Komunikimin elektronik të datës 12.12.2022, 09.12.2022, 21.11.2022, 08.12.2022, 18.11.2022, 10.11.2022; Certifikatën mjekësore të ankueses të datës 11.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.04.2023; Komunikimin elektronik të datës 30.03.2023, 29.03.2023, 21.03.2023, 26.03.2023, 27.03.2023, 20.03.2023, 16.03.2023, 13.03.2023, 10.03.2023, 08.03.2023, 07.03.2023, 06.03.2023, 03.03.2023, 14.03.2023, 09.03.2023, 23.11.2022, 06.11.2022, 04.10.2022, 16.12.2022, 12.12.2022, 09.12.2022, 07.12.2022, 04.03.2023, 21.02.2023, 04.03.2023, 16.12.2022, 24.02.2023, 20.02.2023, 13.12.2022, 22.02.2022, 15.02.2023, 14.02.2023, 30.01.2023, 22.02.2023, 15.02.2023, 17.01.2023, 04.01.2023, 19.12.2022, 22.12.2022, 15.12.2022, 06.12.2022, 02.12.2022, 29.11.2022, 25.11.2022, 15.11.2022, 16.12.2022, 02.12.2022, 01.12.2022, 29.11.2022, 25.11.2022, 14.12.2022, 11.12.2022, 13.12.2022, 12.12.2022; Raportin e prezencës në punë të ankueses për periudhën 01.01.2023-06.04.2023; Tabelën lidhur me llojin e pushimeve mjekësore të ankueses për vitin 2023; Komunikim elektronik të datës 06.04.2023, 27.02.2023, 16.02.2023, 22.02.2023, 21.02.2023, 20.02.2023, 07.12.2022, 21.11.2022, 10.11.2022, 01.12.2022, 04.10.2022, 29.06.2022, 02.02.2022, 15.02.2022; Kërkesën për kompensim me Nr.Prot.5296/22 të datës 16.09.2022; Komunikimin elektronik të datës 11.08.2022, 10.08.2022, 01.08.2022, 28.02.2022, 09.08.2022, 22.07.2022, 21.07.2022, 15.09.2022, 24.11.2022,

21.07.2022, 29.06.2022, 02.10.2022, 28.09.2022, 14.09.2022, 13.09.2022, 12.09.2022, 18.02.2022, 21.08.2022, 10.08.2022, 24.02.2022, 15.02.2022, 10.11.2022, 03.12.2021, 02.12.2021, 01.12.2021, 24.02.2022, 23.02.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne punë për periudhën maj-gusht të vitit 2021 për ankuesen; Komunikimin elektronik të datës 09.09.2022, 29.11.2022, 25.11.2022, 15.11.2022, 07.12.2022, 18.11.2022, 30.11.2022, Shkresat zyrtare te lidhur me listën e kërkesave për shkarkim te ujit, për shfrytëzim te ujit, për vazhdimin e lejeve ujore, për hidrocentrale, për koncesion për periudhën 2018-2022; Procesverbalin e datës 07.12.2022 të Komisionit Disiplinor; Komunikimin elektronik të datës 30.11.2022, 29.11.2022; Planin vjetor të punës për vitin 2022; Shkresën zyrtare Nr.6862/2022 të datës 10.11.2022 lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore; Komunikimin elektronik të datës 15.07.2022, 06.11.2022, 04.10.2022, 07.11.2022, 04.11.2022, 15.08.2022, 07.08.2022, 05.08.2022, 03.08.2022, Shkresën zyrtare lidhur me listën e kërkesave për shfrytëzim të ujit; Raportin e prezencës në punë për periudhën 01.01.2022-31.10.2022, 01.01.2021-31.12.2021 të ankueses; Komunikimin elektronik të datës 06.11.2021, 22.10.2021, 20.10.2021, 06.09.2021, 31.08.2021; Vendimin Nr.Prot.4203/21 të datës 04.10.2021, 05.07.2022, 16.06.2022; Vendimin Nr.Prot.3837-2/22 të datës 05.07.2022; Shkresën zyrtare të datës 05.07.2022 lidhur me pëlqimin ujqor; Komunikimin elektronik të datës 03.11.2022, 13.10.2022; Aktvendimin për ndërprerje të punës Nr.Prot.5819/2022 të datës 12.10.2022; Aktvendimin Nr.prot.22-INS-14-TGJ-57 të datës 03.10.2022; Aktvendimin e datës 03.10.2022; Komunikimin elektronik të datës 10.11.2022, 06.03.2022, 18.02.2022, 28.01.2022, 27.01.2022, 10.11.2022, 27.06.2022; Shkresën zyrtare me Nr.prot.3249/22 te datës 09.06.2022 lidhur me peticionin e banorëve për qasje ne ujerat e liqenit te Radoniqit; Komunikimin elektronik të datës 19.06.2022, 18.06.2022, 30.05.2022, 26.05.2022, 30.03.2022; Vendimin e datës 19.04.2017; Kërkesën e datës 14.06.2021; Komunikimin elektronik të datës 26.04.2022, 04.03.2022, 01.03.2022, 12.07.2022; Shkresën zyrtare Nr.Prot.7456/22 të datës 08.12.2022; Vendimin Nr.prot.8346 te datës 29.12.2022 te Komisionit Disiplinor; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.6862/22 te datës 11.11.2022 lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses; Vërejtjen e shqiptuar me Nr.prot.7562/22 të datës 12.12.2022 ndaj ankueses, Ndryshim plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 11.07.2017 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës si dhe Vendimin VK/2023 të datës 19.04.2023 lidhur me vazhdimin e afatit te ankesës në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse*

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës së ankueses, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 127 paragrafit 4, në të cilin përcaktohet se: *"Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"* dhe në këtë kuptim ka konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill me datën 10.03.2023, kundrejt Vërejtjes me shkrim me Nr.Prot.7562/22 të datës 12.12.2022 e shqiptuar nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, është e pranueshme për faktin se e njëjta është nxjerrë pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), sipas dispozitës në fjalë.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vërejtjen me shkrim të datës 12.12.2022 me Nr.Prot.7562/22 e shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses dhe rrjedhimisht ka gjetur se kjo vërejtje bazohet në faktin se ankuesja ka munguar pa arsye në punë, për sjellje jo të mirë dhe ashpërsim të gjuhës me kolegët në punë, mos përmbushje e detyrave dhe cenim i hierarkisë në institucion.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 46 me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", nenit 47 paragrafit 1 me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenit 48 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit".

Në aspektin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua poashtu dispozitave të nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", dhe ndërlidhur me situatën juridike të pretenduar, Kolegji pasi ka analizuar faktet dhe provat të cilat janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës lidhur me çështjen në fjalë, ka konstatuar se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga elementet që do ta bënte përgjegjëse ankuesen lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara sipas vërejtjes së shqiptuar, ngase udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të së njëjtës fillimisht lidhur me faktin se ankuesja ka munguar pa arsye në punë, nuk ka specifikuar saktë periudhën kohore se për cilat ditë e njëjta ka munguar pa arsye në punë e që lidhur me këtë fakt i njëjti nuk ka arrit të siguroj dëshmitë për mungesën në punë të saj. Po ashtu ndërlidhur me pretendimet e supozuara të udhëheqësit të drejtpërdrejtë lidhur me atë se ankuesja nuk ka pasur sjellje të mira me të dhe me kolegët në punë dhe se e njëjta nuk ka përmbushur detyrat e punës dhe

ka cenuar hierarkinë e punës në këtë institucion, Kolegji ka vlerësuar po ashtu se asnjërën nga këto pretendime të supozuara në këtë vërejtje nuk ka arritur ti faktoj me prova dhe dëshmi sipas të cilave ishte dëshmuar përgjegjësia disiplinore e ankueses në këtë drejtim, pastaj të argumentoj se cilat janë shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj, cila është shkalla e fajësisë, apo a ka pasur përpjekjet e mëparshme të nëpunëses për shmangien apo kufizimin e dëmit, të njëjtës a i është tërhequr vërejtja lidhur me shkeljet e supozuara e që mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses nuk ka ofruar dëshmi lidhur me faktimin e elementeve të përgjegjësive disiplinore të përcaktuara sikurse me nenin 45 ndërlidhur me nenin 50 paragrafin 1 të Ligjit 06/L-114 për Zyrtar Publik , kështu që pretendimet e ankueses në këtë drejtim janë të bazuara dhe ligjore.

Kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese konstaton se pretendimet e ankueses janë të bazuara edhe për faktin se me vendimin Nr.8346 të datës 09.12.2022 të komisionit disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në lidhje me inicimin e procedurës disiplinore nga mbikëqyrësi për ankuesen, me ç'rast përveç tjerash është marrë edhe me konstatime që ndërlidhen edhe me objektin e kësaj ankese dhe përmes këtij vendimi ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses duke qartësuar njëkohësisht me konstatime se ankuesja nuk ka ndonjë përgjegjësi në lidhje me çështje që udhëheqësi i saj i ka konstatuar me rastin e ushtrimit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore.

Ndërlidhur me këtë situatë Kolegji konstaton se, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" në rastin konkret, nuk ka arritur të vërtetoj me dëshmi dhe prova saktë gjendjen faktike lidhur me shqiptimin e së njëjtës siç parashihet me dispozitat e nenit 47 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.1/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke arsyetuar në mënyrë të detajuar veprimet e kundërligjshme të ankueses bazuar në provat relevante.

Andaj mbi bazën e dispozitave ligjore të lartcekura dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore Vërejtje me shkrim e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, përveç që sa i përket përmbajtjes nuk është në harmoni me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është në kundërshtim edhe dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, rrjedhimisht Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që bëjë heqjen-largimin e masës disiplinore ndaj ankueses nga dosja personale e saj sipas këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana e në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetarit të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.482/2023, datë 05/05/2023.

Ardita PERÇUKU-SHYTI



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.